

# **Raporti i Audituesit te Pavarur**

## **Për Raportet e Financimit te Fushatës Zgjedhore 2021**

---

**Partia Demokratike e Shqiperise, PD**

## **I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

### **A. INFORMACIONI LIGJOR**

#### **i. Kuadri ligjor**

Ligji nr. 10091, date 5.03.2009 "Per auditimin ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar" i ndryshuar

Standartet Nderkombetare te Auditimit

Ligji nr. 10019 date 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i R. Sh. i ndryshuar.

Ligjin nr. 8580, date 17.02.2000, "Per partite politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017 date 22.05.2017,

Aktet nenligjore te KQZ

Vendimi i KQZ-së "Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve kontabel te licensuar(Auditues Ligjor) , te cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore 2021.

- #### **ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme**
- Standartet Kombetare te Kontabilitetit SKK

### **B. OBJEKTI I AUDITIMIT**

- #### **i. Kontrata e shërbimit nr 4681 date 20/09/2021, lidhur ndermjet Komisionit Qendror te Zgjedhjeve KQZ (porositesi) dhe Anida Nuri, Audituese ligjore (ofruesi i sherbimit). Objekti i kontrates eshte "Kryerja e auditimit te detyrueshem te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet 2021, te dates 25.04.2021, nga subjektet zgjedhore (parti politike qe garojne me vete ose pjese e nje koalicioni, kandidat i propozuar nga zgjedhesit) si dhe kandidatet e listave shumeemeroe ne perputhje me ligjin nr 1019, date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise" i ndryshuar, ligjin nr nr.8580, date 17.02.2000, "Per partite politike" i ndryshuar, aktet nenligjore te KQZ te miratuara per kete qellim, ligjin nr. 10091, date 5.03.2009 "Per auditimin ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar" i ndryshuar, dhe**



ligjin nr. 9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar, si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne baze dhe per zbatim te tyre.

- ii. Udhezimi i KQZ-së -: -Vendim Nr 13, dt. 6.04.2021 Per përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore" -Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e audituesve ligjore, te cilet do te kryejne auditimin e fondeve dhe shpenzimeve te fushates zgjedhore per vitin 2021.
- iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

#### *Përgjegjësitë e subjektit zgjedhor*

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të te dhenave sipas formatit te standartizuar te raportimit financiar per fushaten zgjedhore , dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të subjektit zgjedhor.

#### *Përgjegjësitë e Audituesit*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat e raportimit financiar per fushaten zgjedhore në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

-Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat e raportimit financiar per fushaten zgjedhore, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontroleve të brendshme.



-Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm.

-Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera

-Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave të raportimit financiar për fushatën zgjedhore dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

### **C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR**

#### **i. Prezantimi i subjektit zgjedhor**

Partia Demokratike e Shqipërisë, PD, është parti politike, regjistruar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës. Me urdher të datës 12.12.1990 të Ministrisë së Drejtësisë është miratuar krijimi i Partisë "Partia Demokratike", me iniciale PD ose PDSH. Kryetar i saj është z. Lulzim Basha. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8580 dt. 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar; ligjit 8788 dt. 7.05.2001 "Për Organizatat Jofitimpruese", ligjit 8779, dt. 7.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimpruese", nga statuti i saj dhe ligjet e tjera në fuqi. Partia Demokratike ka për qëllim konkurimin politik përmes zgjedhjeve të përgjithshme, në respekt të vlerave të lirise, barazise dhe drejtësisë në një garë politike. Qëllimet politike: PDSH-ja njih dhe promovon pjesëmarrjen e gjerë popullore në jetën politike, shoqërore dhe në institucione, si dhe kujdeset për formimin e një vullneti të gjerë e të qëndrueshëm popullor në dobi të mbrojtjes dhe zhvillimit të traditave më të larta shoqërore, politike dhe kulturore të shqiptarëve, në dobi të realizimit dhe zhvillimit të shpejtë të aspiratave euroatlantike të Shqipërisë, si dhe rrezatimin pozitiv të imazhit të vendit kudo në botë, për përjetësimin e kombit shqiptar, identitetin e kulturës së tij; etj.

Selia e PD është në adresën: Bulevardi Zhan D'Arc, 11, Tiranë.

Qëllimi dhe objektivat e PD gjejnë pasqyrim në Programin dhe Statutin e saj. Në këtë statut ajo ka rregulluar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të saj, ka përcaktuar organet drejtuese në nivel qendror dhe lokal. Aty janë përcaktuar dhe të drejtat e detyrimet e anetaresive të saj, burimet e financimit, të cilat duhet të jenë ligjore si dhe rregullat e përdorimit të këtyre fondeve në dobi të aktivitetit politik të kësaj partie

#### **ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe degët rajonale)**

Partia PD ka seline ne qytetin e Tiranes dhe ka 53 dege te tjera rajonale


**D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ**

- i. Struktura e raportit të auditimit
  - kërkesat formale
  - të ardhurat
  - shpenzimet
- ii. Gjate procesit te auditimit, audituesi ligjor ka kontaktuar me pergjegjesin per financat e partise z. Ilir Dervishi, i cili ka dhene informacionet e kerkuara
- iii. Partia PD ka pergatitur raportin e financimit të fushatës zgjedhore në përputhje me kërkesat e raportimit

**II. KËRKESAT FORMALE**

**A. PËRMBLEDHJE**

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike	Po	Datë 9.09.2021
	b) dorëzim fizik	Po	Datë 9.09.2021
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	Datë 09.09.2021
3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës i financës			



	a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare	Po	
	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës	Po	
	c) identiteti i personit përgjegjës të financës	Po	Ilir Dervishi

## **B. ANALIZA**

### **a/ Llogaria bankare e veçantë**

#### **- Llogaria bankare**

- subjekti zgjedhor ka llogari bankare te vecante per fushaten zgjedhore ne Raiffeisen Bank, ne te cilen eshte kryer transferta nga fondet publike per fushaten zgjedhore.
- subjekti zgjedhor ka llogari bankare te tjera, që janë përdorur për të paguar disa nga shpenzimet e fushates, nje llogari ne leke ne Raiffeisen bank dhe nje llogari ne leke ne Union Bank
- Llogaria bankare e posacme eshte përdorur dhe për zgjedhjet e mëparshme
- Raporti i financimit të fushatës zgjedhore është i balancuar. Subjekti zgjedhor nuk i ka paguar te gjitha detyrimet e fushates zgjedhore. Aktualisht nuk eshte paguar shuma prej 90,000 lekesh, per shpenzime qera zyra.

#### **- Plotesia e informacionit**

- Ka evidence te llogarisë bankare te posacme, nxjerrje llogarie nga banka me transaksionet per fushaten zgjedhore.
- Ka tre dokumenta te lëvizjeve bankare (bank statement) që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore per tre llogarite e siperpermendura

### **b/ Personi përgjegjës për Financën**

#### **- Identiteti i personit përgjegjës për financën:**

- Personi përgjegjës për thesarin (financat) e partise eshte Ilir Dervishi.
- Çështje të mospërputhjeve të mundshme
- 

#### **- Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:**



- Nënshkrimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore është bërë nga Gazment Bardhi.
- Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: zbulimi i problemeve të paraqitjes:

	a) bosh/mungon informacioni	Jo		
	b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
		<b>Të Ardhurat</b>		
		Financime publike		33,318,149
		Donacione private (ne natyre)		1,481,321
		Financim nga burimet e veta të partisë		10,722,565
		Te ardhura nga kandidatet		2,103,625
		Huatë/Kreditë		0
		<b>Shpenzimet</b>		
		Mitingje/tubime dhe aktivitete ne fushatë		147,732
		Materialet promovuese		7,260,000
		Media		20,564,624
		Media sociale		6,715,528
		Sondazhe		0
	Botime/Publikime		0	
	Transporti		438,000	
	Konsulenca		8,610,000	
	Reklamime në natyre		0	
	Shpenzime administrative		1,786,150	
	Shpenzime nga kandidatet		2,103,625	

Shenim: Nuk me eshte vene ne dispozicion dokumentacioni i kandidateve per financimet dhe shpenzimet

### III. TË ARDHURAT

#### A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
<b>1/ Financimi publik</b>			
	Fondi i marrë paradhënie	33,318,149	33,318,149
	Data e marrjes së fondit	16/04/2021	16/4/2021
	Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve	0	0
	Data e transfertës	-	-
	Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka	0	0
	Data e transfertës	-	-
<b>2/ Donacionet private</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	1,481,320.71	1,481,320.71
	Shuma e donacioneve në para	0	
	Shuma e donacioneve në natyrë	1,481,320.71	1,481,320.71
	Përgatitet një listë e donatorëve		Po
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)		Po
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të		NA



	lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (shuma)		
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		NA
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori)		NA
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		N/A
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		Po
	Respektimi i kufirit të donacionit		po
<b>3/ Financimi nga burimet e vetë partisë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	10,722,565	10,722,565
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	10,722,565	10,722,565
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>	10,722,565	10,722,565
	<i>Botimet</i>	-	-
	<i>Shtypshkronja</i>	-	-
	<i>Marrje me qera</i>	-	-
	Shuma e përgjithshme e raportuar (kandidatet)	2,103,625.43	-
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>	-	-
	<i>Botimet</i>	-	-
	<i>Shtypshkronja</i>	-	-
	<i>Marrje me qera</i>	-	-
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma)	-	-
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)	-	-
<b>4/ Huatë/Kreditë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	0	0

	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	-	-
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)	-	-
<b>5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave</b>			
	Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.	J0	J0

Shenim: Nuk me eshte vene ne dispozicion dokumentacioni i kandidateve per financimet dhe shpenzimet

## **B. ANALIZA**

### **a/ Financimi publik**

- Partia Demokratike e Shqiperise ka perfituar fonde publike te paracaktuara ne shumen 33,318,149 leke.
- Kontrolli i minutazhit që subjekti zgjedhor ka marrë nga çdo sektor i medias që siguron kohë të lirë transmetimi. Partia Demokratike e Shqiperise ka perfituar kohe te lire transmetimi, reklama, publikime per qellime te fushates zgjedhore me financim publik ne shumen 7,825,074 leke.
- Rast abuzimi, keqperdorimi të burimeve publike nuk eshte evidentuar.

### **b/ Financimi nga burimet jo publike**

- **Donatorët e lejuar:**
  - o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar:  
Financimi nga burimet jo publike – Partia Demokratike e Shqiperise ka perfituar financime jopublike brenda kufirit te lejuar, kontribut ne natyre per 41 zyra zgjedhore ne shumen 1,481,320,71 leke. Kandidatet e kesaj partie gjithashtu kane perfituar financime jopublike brenda kufirit te lejuar, ne shumen totale 2,103,625.43 leke. Per keto financime te kandidateve nuk me eshte vene ne dispozicion dokumentacion nga subjekti zgjedhor.
  - o Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë: - Nuk ka tejkallim te shumes se donacionit nga i njejti donator.
- **Burimet e palejuara** – Nuk jane evidentuar burime te palejuara, por nuk me eshte vene ne dispozicion dokumentacion nga subjekti zgjedhor per deklaratat e donatoreve



- **Kontributet në natyrë** – Partia Demokratike e Shqipërisë ka përfituar financime jopublike, kontribut në natyrë për 41 zyrë zgjedhore në shumën 1,481,320,71 leke. Kandidatet e kësaj partie gjithashtu kanë përfituar financime jopublike brenda kufirit të lejuar, në shumën totale 2,103,625.43 leke. Për këto financime të kandidatëve nuk është vënë në dispozicion dokumentacion nga subjekti zgjedhor. Duke qenë se rreth 50% e kandidatëve nuk kanë kryer raportim të financimeve e shpenzimeve të fushatës zgjedhore, dhe 41 zyrë nuk është numri total i zyrave të subjektit zgjedhor, konkludojmë që vlera e kontributit në natyrë për zyrë zgjedhore të jetë më e lartë, të paktën dyfish i vlerës 1,481,320.71 leke.

- o **Kufizimet**

Nuk ka shkelje të kufizimeve.

**c/ Financimi nga burimet e vetë partise –**

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partise - 10,722,565 leke**
  - o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra – 10,722,565 leke
  - o Botimet –
  - o Shtypshkronjat –
  - o Marrja me qera, etj –
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**
  - o Zyrat Qendrore - 10,722,565 leke
  - o Degët lokale - 0
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruara dhe deklarimit bankar (bank statement)**

Nuk ka mosperputhje

**d/ Huatë/Kreditë – nuk ka**

**IV. SHPENZIMET**

**A. PËRMBLEDHJE**

Shuma e përgjithshme e raportuar		47,625,660 leke					
Respektimi i kufirit të shpenzimit		Po					
<b>Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë</b>							
	<b>Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore</b>	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	<b>Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit</b>
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	147,732						147,732
Materialet promovuese	7,260,000						7,260,000
Media	20,564,624						20,564,624
Media sociale	6,715,528						6,715,528
Sondazhet e opinionit publik	0						0
Botimet	0						0
Transporti	438,000						438,000
Konsulenca	8,610,000						8,610,000
Reklammat në ambientet e jashtme	0						0

Administrative dhe të përgjithshme	1,786,150				90,000		1,786,150
<b>Shpenzimet e bëra nga degët e partisë</b>							
	<b>Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore</b>	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	<b>Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit</b>
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	-						-
Materialet promovuese	-						-
Media	-						-
Media sociale	-						-
Sondazhet e opinionit publik	-						-
Botimet	-						-
Transporti	-						-
Konsulenca	-						-
Reklamat në ambientet e jashtme	-						-
Administrative dhe të përgjithshme	-						-
<b>Shpenzimet zgjedhore</b>							
Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Jo

### Shpenzimet e kryera nga Kandidatet

	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	253,000	jo		Faturat, kontrata, marreveshje		Nuk disponojme dokumentacion	253,000
Materialet promovuese	-						-
Media	130,465	jo		Faturat, kontrata, marreveshje		Nuk disponojme dokumentacion	130,465
Media sociale	149,469	jo		Faturat, kontrata, marreveshje		Nuk disponojme dokumentacion	149,469
Sondazhet e opinionit publik	-						-
Botimet	140,600	jo		Faturat, kontrata, marreveshje		Nuk disponojme dokumentacion	140,600
Transporti	165,750	jo		Faturat, kontrata, marreveshje		Nuk disponojme dokumentacion	165,750
Konsulenca	-						-
Reklammat në ambientet e jashtme	-						-
Administrative dhe të përgjithshme	2,820	jo		Faturat, kontrata, marreveshje		Nuk disponojme dokumentacion	2,820

## Shpenzimet zgjedhore per kandidatet

Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë

Nuk disponojme dokumentacion

### B. ANALIZA

a/ **Respektimi i kufirit të shpenzimeve:** - Bazuar ne dokumentacionin e vene ne dispozicion nga subjekti zgjedhor, eshte respektuar kufiri i shpenzimeve maksimale te fushates zgjedhore

b/ **Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruarra dhe klasifikuara sipas kandidateve dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.**

- <b>Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës :</b>	<b>- 253,000 leke</b>
- Shpenzime për vendin/ambjentin;	
- Shpenzimet e zbavitjes/argëtimit;	
- Shpenzimet e pajisjeve;	
- Shpenzimet për pijet;	
- Shpenzimet e reklamave/promocioneve;	
- Shpenzimet e Transportit;	
- Shpenzimet administrative;	
- <b>Materialet promovuese</b>	
- <b>Media</b>	<b>130,465 leke</b>
- <b>Media Sociale</b>	<b>149,469 leke</b>
- <b>Sondazhe</b>	-
- <b>Botimet/Publikime</b>	<b>140,600 leke</b>
- <b>Transporti</b>	<b>165,750 leke</b>
- <b>Konsulenca</b>	-
- <b>Reklammat në natyre</b>	-
- <b>Shpenzime zyre elektorale</b>	-
- <b>Shpenzime administrative</b>	<b>2,820 leke</b>

*Shenim. Nuk disponojme dokumentacion per financimin dhe shpenzimet e kandidateve per fushaten zgjedhore*

### V. PËRFUNDIMI

#### A. SINTEZA

- Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

Subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë ka kryer deklarin sipas ligjit për raportimin financiar për fushatën zgjedhore Prill 2021. Nga auditimi i kryer janë evidentuar parregullsi dhe janë nxjerre konkluzionet si më poshtë

Totali i të ardhurave 47,625,660 leke. Pjesa më e madhe e të ardhurave janë nga financimet publike, në shumën 33,318,149 leke. Pjesa tjetër janë kryesisht kuotat e anëtarëve dhe kontributet në natyrë për zyra zgjedhore  
Totali i shpenzimeve 47,625,660 leke. Pjesa më e madhe e shpenzimeve është kryer për median dhe median sociale, në shumën 27,280,152 leke. Një përqindje të lartë zënë konsulentat dhe materialet promovuese, si dhe ka shpenzime të tjera administrative, transporti etj.

Financimet publike për median (sipas ligjit) janë në shumën 7,825,074 leke. Kjo vlerë nuk është përlogaritur në vlerën totale në raport.

Për vlerën e zyrave zgjedhore të pallogaritura në raport, si rrjedhojë e mungesës së deklarinimit të kandidatëve është bërë një përlogaritje mesatare në vlerën 1,481,320 leke

- Nga numri total i kandidatëve, kanë përgatitur dhe deklaruar pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore rreth 50% e kandidatëve, ku shumica e deklarinimeve janë zero, pa financime apo shpenzime.
- Subjekti zgjedhor ka një llogari të posaçme për të arketuar financimet dhe kryer pagesat për shpenzimet e fushatës zgjedhore. Pagesat për shpenzimet e fushatës zgjedhore nuk janë kryer vetëm në llogarinë e posaçme por në disa raste edhe në 2 llogari të tjera bankare.

o Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit –

- Nuk kanë përgatitur dhe deklaruar sipas ligjit, pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore, rreth 50% e kandidatëve
- Mungojnë deklarinatat e donatorëve mbi konfliktin e interesave për financimin e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre
- Pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore, nga kandidatët që kanë kryer deklarinimet, kanë pasaktësi në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, megjithatë nuk janë vlera të konsiderueshme, në total 2,103,625.43 leke për 5 deklarinime të kandidatëve. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të balancuara. Mungojnë të dhëna për faturat. Në një rast mungon vlera monetare e llogaritur për kontributin në natyrë.

- o Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertit financiar  
Nuk disponojmë të dhëna të vlefshme për vlerësim financiar nga procesi i monitorimit.





## B. PËRFUNDIMI

### Opinionit me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, të cilat përfshijnë pasqyrat sipas formatit të standardizuar të raportimit financiar për fushatën zgjedhore.

Sipas opinionit tonë, përveç çështjeve të përmendura tek baza për Opinionin me rezervë, pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, financimet dhe shpenzimet, në përputhje me kuadrin rregullator në Shqipëri.

### Baza për Opinionin me rezervë

Ne pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore të subjektit zgjedhor, nuk janë përfshirë të gjitha deklaratat e kandidatëve për deputet të kësaj partie. Nga numri total i kandidatëve, kanë dorëzuar pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore rreth 50% e kandidatëve.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit. Ne jemi të pavarur nga subjekti zgjedhor në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave, raporteve financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Anida Nuri**  
**Auditues Ligjor**

Tirane më 30.10.2021

